

VENDIM
Nr.498, datë 30.7.2021

PËR MIRATIMIN E KLAUZOLAVE TË STABILITETIT PËR KONTRATËN E KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP TË PORTIT TURISTIK NË QYTETIN E VLORËS “MARINA DI VALONA”, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË “MARINA DI VALONA”, SH.P.K., “MARINA PROJECTS” LTD, “BRUNES”, SH.P.K., “NDREGJONI”, SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e klauzolave të stabilitetit për kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënie me koncesion/PPP të portit turistik në qytetin e Vlorës “Marina di Valona”, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Marina di Valona”, sh.p.k., “Marina projects” LTD, “Brunes”, sh.p.k., “Ndregjoni”, sh.p.k.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe